



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 26.12.2023

Drejtuar: Operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” sh.p.k me NUIS J61817047D

Me adresë: **Blv. “Zhan D’Ark”, Nd. Nr. 32, H. Nr. 16, Kati nr. 2, Ap. Nr. 1, Tiranë**

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-76141-07-26-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pajisje Informatike (Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader)”, me fond limit **70.000.000 (shtatëdhjetë milion)** lekë pa TVSH., malli do të dorëzohet për 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 31.07.2023, nr. 66

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj, ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Infosoft Systems” sh.p.k me NUIS J61820021C me vlerë të ofertës ekonomike **53,087,960** (pesëdhjetë e tre milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH;
2. Operatori Ekonomik “BNT ELECTRONICS” sh.p.k me NUIS J61817047D me vlerë të ofertës ekonomike **56,360,900** (pesëdhjetë e gjashtë milion e treqind gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH;
3. BOE “Atom” sh.p.k me NUIS L22203042N, & “Erisony Company” me NUIS K92006501A, me vlerë të ofertës ekonomike **58,700,000** (pesëdhjetë e tetë milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH;

4. Operatori Ekonomik "SINTEZA-CO" sh.p.k me NUIS K11324003F me vlerë të ofertës ekonomike **62,873,500** (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë pa TVSH;
5. Operatori Ekonomik "I.S.S" sh.p.k me NUIS L92230027U me vlerë të ofertës ekonomike **69,360,000** (gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik "Infosoft Systems" sh.p.k me NUIS J61820021C

Nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe konkretisht nuk plotësohet:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

1. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, duhet të plotësohet në çdo seksion të tij duke cituar edhe faqen e internetit apo burimin e dokumentit që vërteton që OE nuk është në kriteret për skualifikim.

OE "**Infosoft Systems**" nuk e ka plotësuar Formularin e Vetëdeklarimit në mënyrën e kërkuar nga ligji, pasi nuk ka deklaruar në formular vetëdeklarimi, konkretisht në **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit** ortakun **Tag Engineering shpk, i cili sipas ekstraktit të QKB rezulton ortak me pjesëmarrje në 30%**, nëse është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata. Rikujtojmë që personat juridike kanë përgjegjesi penale sipas Ligjit Nr.9754, datë 14.6.2007 Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike, prandaj duhen deklaruar në formular vetëdeklarimi si ortak i OE Infosoft Systems.

Tek formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, nuk është plotësuar në mënyrë korrekte seksioni **B: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), pasi janë vendosur vetëm emërtimi i kriterit të kërkuar në DST dhe nuk është vendur emri i plotë i punonjësit që deklarohet se përmbush kriterin.**

Referuar nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të RrPP, formulari i vetëdeklarimit plotësohet duke saktësuar dokumentin e kërkuar dhe burimin/faqen e internetit ku është marrë ky dokument.

2. **BOE "Atom" sh.p.k me NUIS L22203042N,&Erisony Company me NUIS K92006501A;**
Nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe konkretisht nuk plotësohet:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

1. Antari i BOE ERISONI nuk ka plotësuar në mënyrë korrekte, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pasi tek Pjesa: Informacion në Lidhje me Operatorin Ekonomik nuk kanë deklaruar edhe partnerin ATOM, të dhënat e tij, apo përqindjen e pjesëmarrjes në BOE.

2. Lidhja mes Distributorit Ingram dhe Prodhuesin Zebra, e paraqitur nga antari i BOE ATOM nuk është përkthyer sipas kërkesave të Ligjit Nr. 82/2021 "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar", pasi nuk rezulton të jetë përkthyer nga asnjë përkthyes.

3. Nuk plotëson pikën **2.1.1** Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Softëare për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale.
- Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Management) ose ekuivalente
- Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK

Për të vërtetuar kriterin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomat/certifikatat përkatëse të punonjësit si dhe kontratë të vlefshme pune të lidhura midis operatorit ekonomik dhe punonjësit.

Nga dokumentat e paraqitura apo formulari i vetëdeklarimi nuk janë paraqitur të dhënat për Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale Manage Engine, por një certificate në nivel fillestar (associate), e konfirmuar kjo edhe me prodhuesin e platformës Manage Engine.

4. Nuk plotëson pikën **2.3.5**. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga *prodhuesit* ose nga *distributorët e autorizuar nga prodhuesit*, për tregtimin e artikujve objekt prokurimi.

Dokumenti i paraqitur për zërin Kompjuter të brandit Lenovo nuk është Autorizim prodhuesi, ku duhet të jepen të dhënat si Ref.Objekti dhe Autoritetit kontraktor, por një konfirmim si Rishitës për brandin Lenovo.

3. **Operatori Ekonomik “SINTEZA-CO” sh.p.k me NUIS K11324003F;**

Nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe konkretisht nuk plotësohet:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

1. Nga dokumentat e paraqitura apo formulari i vetëdeklarimi nuk janë paraqitur të dhënat për Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale Manage Engine.

2. Nuk plotëson pikën **2.3.5**. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për tregtimin e artikujve objekt prokurimi.

a) Autorizimi i Prodhuesit “MAF_ASUS”, “MAF_BROTHER (1)”, “MAF_EPSON”, “MAF_HONEYWELL” janë përkthyer në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit Nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, pasi përkthyesja Gradiola Zemuni Merko nuk është pjesë e asnjë zyre përkthimi dhe as nuk rezulton e regjistruar si subjekt tregtar në QKB.

b) Katalogët e emërtuar “Manageengine_integrimi”, “KATALOG_SOFTWARE”, “Katalog KompjuterAsus”, “KATALOG_EPSON_LX_350”, “KATALOG_EPSON_TM-T20X”, “KATALOG_HONEYWELL_CT30_XP”, “KATALOG_HONEYWELL_VOYAGER_XP”, “KATALOG_MONITOR_ASUS”, janë përkthyer në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit Nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, pasi përkthyesja Gradiola Zemuni Merko nuk është pjesë e asnjë zyre përkthimi dhe as nuk rezulton e regjistruar si subjekt tregtar në QKB.

c) Dokumenti i emërtuar “Katalog Brother DCP L2512D”, “KATALOG_BROTHER_DCP_L8410CDW”.

Noterja Aida Hoxha ka kryer njehësimin me origjinalin të dokumentit dhe ka kryer edhe përkthimin, fakt i cili bie në kundërshtim me Nenin 19 të Ligjit Nr. 110/2018 PËR NOTERINË, pasi noteri nuk mund të bëjë asnjë veprimtari tjetër përveç funksioneve të noterit.

3. Nuk plotëson pikën **2.3.3.** për pajisjet Palmar. Referuar katalogut të paraqitur, Pajisja e ofertuar Palmar Honeywell CT30XP nuk plotëson specifikimin:

Siguria Enhanced Open (OWE), LEAP dhe EAP-PWD

4. Nuk plotëson pikën **2.3.6.** Për Integrimin e platformës së menaxhimit në distancë të kompjuterave dhe palmarëve me platformën e menaxhimit ne Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre **.Nuk ka paraqitur vertetim nga prodhuesi per integrimin e platformes** Manage Engine Endpoint Central Cloud + Service Desk Plus + Mobile Device Manager Plus.

5. Nuk plotëson pikën **2.1.1** Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Softëare për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale.
- Të paktën 1 (një) punonjes te certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Managment) ose ekuivalente
- Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK

Për të vërtetuar kriterin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomat/certifikatat përkatëse të punonjësit si dhe kontratë të vlefshme pune të lidhura midis operatorit ekonomik dhe punonjësit.

4. Operatori Ekonomik “I.S.S” sh.p.k me NUIS L92230027U;

Nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe konkretisht nuk plotësohet:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

1. Nuk plotëson kriterin kualifikues për deklarinim në mënyrën e saktë të formularit të vetë deklarinimit konkretisht **Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, Deklarata B ku kërkohet vetëdeklarim Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen).**

OE ka vetëdeklaruar se disponon fuqinë punëtore sipas kërkesave të DST, por ndryshe nga deklarinimet për punonjësit e tjerë, për punonjësin Z. Nertil Lilo është deklaruar që është i certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi i platformës virtuale për menaxhimin e paisjeve kompjuterike dhe palmar, por nuk është dhënë asnjë detaj në lidhje me Nr e certifikatës apo ndonjë link apo databaze online ku mund të verifikohet kjo certifikatë. Po ashtu nuk është ngarkuar certifikata për punonjësin e kërkuar për të plotësuar kriterin në pikën 2.1.1 ku kërkohet të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale.

2. Nuk plotëson kriterin kualifikues të pikës **2.3.1**. Ku Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik për të përmbushur kriterin për realizimin e kontratave të ngjashme, ndër të tjera ka paraqitur edhe një faturë me një OE privat, konkretisht QuanX IT Solution.

Kjo faturë është e vetmja faturë e cila tregon për objektin e ngjashëm me procedurën e zhvilluar nga Posta Shqiptare.

Kjo faturë është lëshuar 4 (katër) ditë para ditës së hapjes së procedurës së tenderimit, fakt i cili bie në kundërshtim me kërkesat e DST në shtojcën 7, ku citohet se për të plotësuar kriterin për kontratat

e ngjashme, duhet që këto kontrata të jenë lëshuar para datës së publikimit të procedurës nga Autoriteti Kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik **“BNT ELECTRONICS”** sh.p.k me NUIS J61817047D me adresë: **Blv. “Zhan D’Ark”, Nd. Nr. 32, H. Nr. 16, Kati nr. 2, Ap. Nr. 1, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **56,360,900** (pesëdhjetë e gjashtë milion e treqind gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vepohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po, Ankesat janë trajtuar nga Autoriteti Kontraktor si dhe është dhënë vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesave nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendim Nr. 1258/2023, datë 05.12.2023 i cili ka vendosur rishikimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ankimues.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ardit Demiri